



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 539/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave, me seli në Prishtinë, rr. “Perandori Justinian”, nr.124, kundër debitorit R... B.I me seli në Skenderaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.1061/19 të datës 08.07.2019 të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 08.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “R... B.I”, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.1061/19 i datës 08.07.2019 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave ka caktuar urdhrin P.nr.1061/19 të datës 08.07.2019 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës nr. 002107 të datës 12.02.2019, me të cilin e ka urdhëruar debitorin R... B.I, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës shumë prej 350.00 € (treqind e pesëdhjetë euro) si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore në pajtim me Udhëzimin Administrativ UA-MD Nr.06/2014, nën kërcënimin të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor me datën 26.07.2019, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se gjatë periudhës për të cilën është iniciuar propozimi për përmbartim, i njëjti nuk ka qenë duke funksionuar për shkak të vjedhjeve të pajisjeve transmetuese duke ia pamundësuar funksionimin e radios, duke shtuar se posedon dëshmi për

ndërprerjen e funksionimit si dhe për këtë është njoftuar edhe kreditori. I ka kërkuar gjykatës që të caktoj seancë publike për tu deklaruar më gjerësisht për të gjitha rrethanat të cilat e kanë sjellë në një situatë të tillë dhe i ka propozuar gjykatës që të aprovohet si bazuar prapësimin i debitorit , të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarrimit, të pezullohen të gjitha veprimet e ndërmarra të përmbarruesit privat dhe të anulohet urdhri.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se debitori ka për qëllim shtyrjen dhe prolongimin e pagesës së borxhit që ka ndaj të kreditorit, ka theksuar se urdhri për përmbarrim është lejuar në përputhje me dispozitat ligjore të përcaktuara në LPP, ka shtuar se debitori nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën e mbështetë pretendimin e tij lidhur me ndërprerjen e aktiviteteve, mirëpo edhe kjo nuk e do ta përjashtonte debitorin nga mos pagesa e tarifës për licenca. Më tutje ka theksuar se debitori nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilën e argumenton se nuk ka borxh ndaj kreditorit dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarrimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarrimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr. 002107 e datës 12.02.2019 në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarrim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së*

detyrimin monetar“, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbardim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbardimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura nr. 002107 e datës 12.02.2019 në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbardim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban as nënshkrimin e pranuesit – debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë se debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën e po ashtu fatura nuk përmban as kohën e përmbushjes së detyrimit monetar, si e tillë e njëjta nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbardueshmërisë.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nuk i plotëson kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbardimit në bazë të dokumentit të besueshëm edhe për faktin se në propozimin për përmbardim nuk është përcaktuar fare afati i përmbushjes së detyrimit, siç parashihet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili përcakton se Propozimi për përmbardim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë *“kërkesën që organi përmbardues ta detyrojë debitorin e përmbardimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara”*.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit Përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin, nuk ka tipare të përmbardueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarduesit duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore si dhe

nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë
Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.539/22, datë 08.09.2022

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi
palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,
nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,
në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.